

VENDIM
Nr. 93, datë 14.2.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 597, DATË 1.7.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE KËRKESAVE TË
HOLLËSISHME PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE VULLNETARE, NDËRMJET
ORGANIZATAVE DHE GRUPEVE QË PËRFAQËSOJNË INTERESA TË CAKTUAR,
GRUPEVE TË OPERATORËVE OSE OPERATORËVE INDIVIDUALË ME
AUTORITETET PËRKATËSE PËR REALIZIMIN E NJË NIVELI MË TË LARTË
MBROJTJEJE, SESA AI I PËRCAKTUAR NË LEGJISLACIONIN E POSAÇËM PËR NJË
PËRBËRËS MJEDISOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 57, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “a” e pikës 5, të vendimit nr. 597, datë 1.7.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Të dhëna të përgjithshme të kërkuarit: emri i personit/ave fizik/ë a juridik/ë, adresa, numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS), personi i kontaktit, informacion të të gjitha lejeve, licencave, autorizimeve dhe vendimeve me të cilat është i pajisur;”.

2. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama